

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A – Dega në Kosovë

Nr. _____ Prot.



Prishtinë, më 05.07.2023

Lënda: Propozim për aprovim të Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandëve të Ditës në Avancë.

Drejtuar: Zyra e Rregullatorit për Energji
Rruga: Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, Prishtinë 10000,
Kosovë

I nderuar z. Fejzullahu,

Duke u bazuar ne dispozitat e Rregullave dhe Procedurave të ALPEX, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, paraqet para Jush propozimin për aprovimin e Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeven të Ditës në Avancë.

Ky propozim është dhënë duke marrë në konsideratë plotësimin e parashikimeve të Procedurës së Tregtimit të ALPEX sh.a e cila parashikon në pikën B.1.5. që çdo urdhërporosi e vendosur nga Anëtari i Bursës duhet të përmbajë të paktën një Çmim Maksimal dhe Minimal të lejuar.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra, vlerëson se zbatimi i Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandëve të Ditës në Avancë, do të ishte një vendim i domosdoshëm për funksionimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Për informimin tuaj, me propozim te ALPEX, Bordi i ERE me vendimin nr. 106 të datës 23.03.2023 ka miratuar këtë rregull për zonën e ofertimit të Shqiperise

ALPEX-i në hartimin e këtij propozimi i është referuar kërkesës nga Neni 5, pika 2.3 i Rregulles për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) për kryerjen e aktiviteteve të ndërlidhura me bashkimin e tregut dhe operimin e tregut të bashkuar, Rregullores Rregullores Nr. 2019/943, datë 05.06.2019 “Mbi Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike” të Parlamentit Evropian, Metodologjinë e parashikuar në përputhje me Nenin 41(1) të Rregullores së Komisionit Evropian Nr. 2015/1222, datë 24.07.2015 “Të Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve” (CACM Regulation), në kuadër të nxitjes së konkurrencës efikase në prodhim, tregtim dhe furnizim me energji elektrike, garantimin e sigurisë operationale, garantimin e trajtimit të drejtë dhe jo

diskriminues të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, të NEMO-ve, të Autoriteteve Rregullatore dhe Anëtarëve të Bursës, dhe duke marrë parasysh nevojën për një treg të drejtë dhe pa probleme dhe formim të drejtë dhe të rregullt të çmimeve, si dhe referuar praktikave të ndjekura nga Bursat e Energjisë të vendeve Evropiane, për vendosjen e çmimeve të harmonizuara Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve një ditë para përsa i përket Single Day Ahead Coupling (SDAC) – Bashkimi i Tregjeve të vetme një ditë para, si dhe vendimit të fundit të konfirmuar nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) dhe Komisioni Evropian dhe pas publikimit të vendimit përkatës të Këshillit të Jashtëzakonshëm për Transport, Telekomunikacion dhe Energji (Extraordinary TTE), të mbledhjes të datës 9 shtator 2022, si dhe duke marrë në konsideratë procedurën e ndjekur nga Ofruesi i Shërbimit (Henex), propozojmë që çmimet të jenë në përputhje me sa më sipër, si vijon:

- a) Çmimi i lejuar Minimal për Ankandin e Tregut të Ditës në Avancë të jetë: - **500€/MWh**
- b) Çmimi i lejuar Maksimal për Ankandin e Tregut të Ditës në Avancë të jetë: **4,000€/MWh.**

Për informimin tuaj, me propozim të ALPEX, Bordi i ERE me vendimin nr. 106 të datës 23.03.2023 ka miratuar këtë propozim për zonën e ofertimit të Shqiperise.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm.

Me respekt,



ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a

Sokol Dishnica

